

VENDIM
Nr.1227, datë 11.12.2009

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.371, DATË 14.6.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË
NËPUNËSVE TË DISA INSTITUCIONEVE, NË VARËSI TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE/KRYEMINISTRIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 "Për buxhetin e vitit 2009", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të pikës 1 të vendimit nr.371, datë 14.6.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohet emërtesa "... Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit.”.
 2. Pagat e punonjësve të tjerë mbështetës të Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit të përcaktohen sipas vendimit për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore.
 3. Efektet financiare, për vitin 2009, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e planifikuara për këtë institucion, për këtë vit.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data e emërimit të nëpunësve në detyrë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha